



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1427/prot.

Vlorë, më 19.11.2018

VENDIM

Nr. 73, datë 19.11.2018

PËR

RIMIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Mbështetur në nenin **33**, në shkronjën **c** të pikën **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresën e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 10178/1 prot., datë 30.10.2018 "Dhënie mendimi mbi projektstatutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë", Vendimin nr. 28, datë 16.11.2018 të Bordit të Administrimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.11.2018

VENDOSI:

1. Të rimiratojë statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë me ndryshimet e mëposhtme të propozuara në shkresën e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 10178/1 prot., datë 30.10.2018 dhe Vendimin nr. 28, datë 16.11.2018 të Bordit të Administrimit:

a) Neni **6**, pika **2** e projektstatutit:

Ishte:

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë zhvillon veprimtarinë e tij institucionale në mënyrë të pavarur, nëpërmjet vetëqeverisjes dhe vetërregullimit të marrëdhënieve, konform legjislacionit në fuqi, me qëllim përmbushjen e objektivave të tij.

Të bëhet:

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale në mënyrë autonome sipas nenit 3 të ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

b) Termat "Doktoraturë" dhe "Master Shkencor" të bëhen sipas parashikimit të ligjit 80/2015:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Vetëm në nenin Neni 11, pika 5 ka ndryshime. Ky nen **ishte**: Qendrat kërkimore-shkencore mund të mbështetin realizimin e programeve të studimit "Master i shkencave" dhe "Doktoraturë" të ofruara nga departamentet e fakultetit ose departamentet e fakulteteve të tjera.

Të bëhet: Qendrat kërkimore-shkencore mund të mbështesin realizimin e programeve të studimit "Master i shkencave" dhe "Doktoratë" të ofruara nga departamentet e fakultetit ose departamentet e fakulteteve të tjera.

c) Neni 13, pika 1:

Ishte:

Njësi ndihmëse me karakter akademik të përbëra nga personel ndihmësakademik me karakter administrativ janë:

Të bëhet:

Strukturat ndihmës-akademike me karakter administrative në nivel institucioni janë:

d) Neni 18, pika 2

Ishte: Vendi i mbetur vakant plotësohet nga kandidati pasardhës në renditje.

Të bëhet:

Në rast se një vend mbetet vakant në Senatin Akademik, plotësimi i këtij vendi duhet të bëhet **nga kandidati pasardhës në renditje** duke u marrë emri nga lista e kandidatëve të zgjedhjeve të fundit.

e) Neni 19, pika 1, gërma j

Ishte:

i paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për arsimin për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, departamenteve, fakulteteve, apo vetë universitetit;

Të bëhet:

i paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për arsimin për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit apo vetë universitetit;

f) Neni 20 të përcaktohet përbërja e Bordit Konsultativ.

Të bëhet:

Anëtarët e Bordit janë personalitete të shquar të huaj ose shqiptarë, me arsimim dhe punësim në organizma prestigjioz, të spikatur në fushën e arsimit dhe shkencës.

g) Neni 22 pika 1:

Ishte:

1. Komisionet e përhershme, të renditura si vijon, në Universitetin "Ismail Qemali" janë organe kolegjinale jovendimarrëse, por këshilluese dhe rekomanduese, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara sipas këtij Statuti.

Të bëhet:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.

h) Neni 22, pika 7:

Ishte:

Komisioni i dhënies së titujve "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" (KDTP):

a) Komisioni i dhënies së titujve "Profesor i asociuar" dhe "Profesor (KDTP) përbëhet nga 7 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit të Dhënies së Titujve Akademikë. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Bazuar në aktet nënligjore, komisioni me miratimin e SA-së mund të vendosë edhe kritere të tjera, përveç kritreve standarde, sipas fushave të studimit dhe nevojave të universitetit.

b) Mënyra e funksionimit të komisioneve të përhershme përcaktohet në rregulloren e Universitetit.

c) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Profesoratit. Kur nuk ka të tillë, Senati shpall vendin vakant dhe zgjedh anëtarin e ri nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Të bëhet:

Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik:

a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik përbëhet nga 7 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit të Dhënies së Titujve Akademikë. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Bazuar në aktet nënligjore, komisioni me miratimin e SA-së mund të vendosë edhe kritere të tjera, përveç kritreve standarde, sipas fushave të studimit dhe nevojave të universitetit.

b) Mënyra e funksionimit të komisioneve të përhershme përcaktohet në rregulloren e Universitetit.

c) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik. Kur nuk ka të tillë, Senati shpall vendin vakant dhe zgjedh anëtarin e ri nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Po ashtu te akronimet dhe shkurtesat të hiqet akronimi KDTP Komisioni i dhënies së titujve "Prof asoc" dhe "Prof".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

i) Përsa i përket pikës 32 të nenit 31, e cila sipas MASR-së duhet të rishikohet sipas nenit 39, pika 5 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit të MASR nr.27, datë 29.12.2017, ku sqarohet se kontrata e punës për personelin administrativ nënshkruhen nga administratori, argumentojmë si më poshtë:

Neni 39, pika 5 e ligjit 80/2015 nuk ka të parashikuar që Rektori nënshkruan vetëm kontratat e punës së personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë. Po ashtu dhe udhëzimi i MASR-së nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", nuk ka në asnjë pikë të tij të parashikuar se kontrata e punës për personelin administrativ nënshkruhen nga administratori, por ka parashikuar organizimin për nga varësia hierarkike të strukturave ndihmësakademike dhe administrative. Sipas pikës 15 të këtij udhëzimi strukturat ndihmësakademike, me karakter akademik dhe ndihmësakademik, me karakter administrativ janë në varësi të rektorit të institucionin publik të arsimit të lartë, si rrjedhim struktura e burimeve njerëzore (strukturë ndihmësakademike, me karakter administrativ) është në varësi vetëm të Rektorit.

Në kuptim edhe të dispozitave të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, punëdhënës është titullari i institucionit dhe në nenin 16 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" është parashikuar se titullar i institucionit të arsimit të lartë është Rektori, si rrjedhim Rektori është punëdhënës i të gjithë personelit të IAL-së.

j) Neni 34, pika 1, gërma n:

Ishte: nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve;

Të bëhet: nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;

k) Neni 54, pika 1:

Ishte: Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e Rektorit.

Të bëhet: Masat disiplinore për personelin akademik jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e Rektorit.

l) Neni 78, pika 2

Ishte: Regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë kundrejt tarifës përkatëse, që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të VKM nr. 560, datë 23.09.2018, **të bëhet:**

Regjistrat shpërndahen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore kundrejt tarifës përkatëse, që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

m) Neni **82**, pika **2** të shtohet sipas parashikimit të nenit 103, pika 4 të ligjit 80/2015.

Ishte: Funkcionet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë :

- a) Të realizojë në praktikë politikat e Rektorit, SA-së dhe të Rektoratit në fushë të sigurimit të brendshëm të cilësisë në vlerësimin institucional dhe vlerësimin e programeve të studimit;
- b) Të hartojë rregulloren e funksionimit të tij në formën e manualit, si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse;
- c) Të kryejë gjithë veprimtarinë administrative (dokumentacion, pyetësor) në funksion të komisioneve, autoriteteve, organeve, personave që përfshihen me detyra konkrete në këtë fushë.

Të bëhet: Në nenin **82**, pika **2** të shtohet pika **d** me përmbajtje: Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.

n) Për propozimin "Kreu IX për veprimtarinë kërkimore-shkencore të paraqitet më i zgjeruar" Senati Akademik kërkon të saktësohet se në çfarë aspektesh duhet të zgjerohet e detajohet ky kre.

2. Projektstatuti të jetë në 2 (dy) kopje, si dhe të nënshkruhet e vulozet në çdo faqe.
3. Vendimi i përcillet MASR-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT
Prof. Dr. Roland Zisi

